



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 11, 12.2 shkronja d) dhe 14 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenit 17 të Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës nr.06/L-092, nenit 17 të Rregullores QRK nr.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, si dhe në bazë të neneve 15 paragrafi 2.4, dhe nenit 17 të Statutit të Komunës nr.01-020/01-0050862/18, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 31 korrik 2023, miratoi këtë;

V E N D I M

PËR FORMIMIN E KOMISIONIT VLERËSUES

Për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës – Lokalet Afariste, në sipërfaqe 50 m² dhe 55 m² të ndërtuar në njësinë kadastrale P-71712062-00459-0, ZK Podujevë

Neni 1

1. Formohet Komisioni vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës sipas Vendimit nr.prot.01-463/06-0055107/23 të datës 31.07.2023 për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtshme të Komunës të pronës së paluajtshme të Komunës - 2 Lokale Afariste në sipërfaqe 50 m² dhe 55 m² të ndërtuar në njësinë kadastrale P-71712062-00459-0, në Zonën Kadastrale Podujevë, në këtë përbërje:

- **Fatlum Osmani**, nga Ekzekutivi i Komunës
- **Pajtim Balaj**, nga Ekzekutivi i Komunës
- **Ekrem Rrahmani**, nga Kuvendi i Komunës
- **Ragip Fetahu**, nga Kuvendi i Komunës
- **Arbenita Hyseni**, nga sektori joqeveritar lokal

2. Kryesuesi i Komisionit zgjedhet me shumicën e votave të anëtarëve të këtij komisioni dhe i njëjti organizon dhe kryeson punën e komisionit.

Neni 2

Mandati i Komisionit është i përkohshëm dhe caktohet për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme, përkatësisht për zbatimin e Vendimit me nr.prot.01-463/06-0055107/23 të Kuvendit të Komunës për miratimin paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës të paluajtshme të Komunës të datës 31 korrik 2023.

Neni 3

Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit janë të përcaktuara me Ligjin për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës si dhe Rregulloren QRK 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës.

Neni 4

Drejtoritë dhe shërbimet tjera përkatëse të Administratës së Komunës i ofrojnë përkrahje këtij komisioni vlerësues për zbatimin e proceduarave për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës.

Neni 5

Zbatimin e këtij vendimi, në përkujdesje të Kryetarit të Komunës e bën Drejtoria e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë.

Neni 6

Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform nenit 81 të ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, dhe nenit 9 paragrafi 8 të Rregullores (QRK) nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, me plotësim ndryshimet e bëra me Rregulloren nr.06/2021.

Nr.Prot. 01-463/06-0055262/23
Podujevë, datë; 31 korrik 2023



Kryesuesi i Kuvendit
Hilmi Hoxha